

**DREJTUAR:**  
**KËSHILLIT MËSIMOR-SHKENCOR TË FAKULTETIT**  
**FILOLOGJIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

Në pajtim me nenin 173 të Ligjit të Arsimit të Lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/2018), me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, nr. 18-1075/1 të datës 28. XI. 2022, në bazë të Konkursit të shpallur më 16. XI. 2022 në gazetën ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“ si dhe në web faqen e Universitetit [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Fonetikë, Fonologji (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1 dhe 2), Gramatika, Semantika, Semiotika, Sintaksa (Sintaksa e gjuhës shqipe 1 dhe 2) dhe Historia e gjuhës (Historia e gjuhës shqipe 1 dhe 2), (64013, 64014, 64018, 64020 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe u zgjodhë unanimisht Komisionin recensues në këtë përbërje:

- 1. Prof. dr. Asllan HAMITI** (kryetar) – profesor ordinar në Fakultetin Filologjik „Bllazhe Koneski“ të Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ – Shkup,
- 2. Prof. dr. Izmit DURMISHI** (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës,
- 3. Prof. dr. Valbona TOSKA** (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin Filologjik „Bllazhe Koneski“ të Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ – Shkup.

Duke falënderuar për besimin e dhënë, Komisioni recensues dorëzon këtë

**R E F E R A T**

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIN FONETIKË, FONOLOGJI (DREJTSHKRIMI I GJUHËS SHQIPE 1 DHE 2), GRAMATIKA, SEMANTIKA, SEMIOTIKA, SINTAKSA (SINTAKSA E GJUHËS SHQIPE 1 DHE 2) DHE HISTORIA E GJUHËS (HISTORIA E GJUHËS SHQIPE 1 DHE 2), (64013, 64014, 64018, 64020 NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT) NË PROGRAMIN STUDIMOR GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE TË FAKULTETIT FILOLOGJIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në konkursin e shpallur në gazetën ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“ të datës 16. XI. 2022 si dhe në ueb-faqen e Universitetit [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Fonetikë, Fonologji (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1 dhe 2), Gramatika, Semantika, Semiotika, Sintaksa (Sintaksa e gjuhës shqipe 1 dhe 2) dhe Historia e gjuhës (Historia e gjuhës shqipe 1 dhe 2), (64013, 64014, 64018, 64020 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, është paraqitur vetëm kandidati **prof. dr. Berton Sulejmani**.

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe të të dhënave të tjera të kandidatit, Komisioni recensues jep këto konstatime dhe vlerësime:

## **Të dhëna biografike dhe arsimimi:**

Kandidati Berton Sulejmani ka lindur më 14 qershor 1977 në Shkup. Shkollimin fillor e kreu në Shkollën Filllore „Liria“ në Shkup. Në vendlindje e kreu edhe shkollimin e mesëm në Gjimnazin „Zef Lush Marku“ në Shkup. Në vitin akademik 1995/1996 është regjistruar në Fakultetin e Filologjisë „Bllazhe Koneski“ të Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ në Shkup në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare. Në bashkëpunim me shumë studentë ai ka ndihmuar në punën e themelimit të revistës së parë të studentëve të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të fakultetit të lartpërmendur „Rrezja“. U diplomuar më 30. VII. 2000 dhe fitoi titullin *profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe*. Pas diplomimit, prej vitit 2001 e deri në vitin 2006 punoi në Gjimnazin „Zef Lush Marku“ në Shkup si profesor i lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë.

Në vitin akademik 2004/2005 është regjistruar në studimet pasuniversitare (studime të magjistraturës nga fusha e gjuhës shqipe) në Fakultetin e Filologjisë „Bllazhe Koneski“ të Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ në Shkup. Pas dhënies së provimeve të parapara, më 9. I. 2008, mbrojti me sukses temën e magjistraturës me titull: „Niveli i zotërimit të shqipes standarde nga nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Shkupit“ dhe mori titullin shkencor *magjistër i shkencave filologjike*. Me këtë rast vlen të theksohet se me studimin e përpjekjen e Berton Sulejmanit, gjuhësia shqiptare fiton të dhëna se në ç’nivel nxënësit e shkollave të mesme të Shkupit e shkruajnë dhe e flasin gjuhën standarde shqipe, ku i bëjnë gabimet më të shpeshta në fushën e fonetikës, fonologjisë, morfologjisë, sintaksës, drejtshkrimit e deri te shenjat e pikësimit.

Gjatë kësaj periudhe, Berton Sulejmani herë pas herë është shfaqur me shkrime publicistike në gazetatat dhe revistat tona, si: „Fakti“, „Lajm“, „Koha“, „Rrezja“, „Interphone“ e të tjera. Nga viti 2002-2004 ka qenë kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i revistës së nxënësve të Gjimnazit „Zef Lush Marku“ me titull „Interfon“. Njashtu në këtë revistë, herë pas here ka botuar shkrime të ndryshme. Në vitin 2005, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës i ndau *certifikatë* për trajnimin e kryer me sukses në kuadër të projektit për modernizimin e arsimit.

Në të njëjtin vit (2005), USAID-i i ndau *certifikatë* për pjesëmarrje në trajnimin e metodave të mësimdhënies me temë: „Duke lexuar dhe shkruar deri në të menduarit kritik“ që ishte pjesë e projektit për mësimdhënie e mësim kreativ. Gjatë këtyre viteve, gjithashtu ka punuar si profesor i gjuhës shqipe (si gjuhë joamtare) në disa shkolla private. Por, në të njëjtën kohë, ka mbajtur edhe orë private/individuale me kandidatë (kryesisht maqedonas) që gjuhën shqipe s’e kanë gjuhë amtare.

Në vitin akademik 2008/2009 kandidati mr. Berton Sulejmani është regjistruar në studimet e doktoraturës në Fakultetin Filologjik „Bllazhe Koneski“ të Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ në Shkup. Më 10. VI. 2010 e mbrojti me sukses disertacionin e doktoratës me temë: „Kongruenca e gjymtyrëve kryesore të fjalisë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase - analizë krahasimtare“ para komisionit në përbërje: 1. Prof. dr. Agim POLOSKA (mentor), 2. Prof. dr. Zhivko CVETKOVSKI (kryetar), 3. Prof. dr. Asllan HAMITI (anëtar), 4. Prof. dr. Dimitar PANDEV (anëtar), 5. Doc. dr. Valbona TOSKA (anëtar) dhe fitoi titullin *doktor i shkencave filologjike*.

Ky disertacion, me të cilin e mori gradën shkencore *Doktor i shkencave filologjike*, është rezultat disavjeçar i punës kërkimore-shkencore të tij. Me këtë punim, kandidati Sulejmani dëshmon seriozitetin e tij shkencor duke paraqitur një punim të mbarështuar mirë dhe plotësisht të kryer kërkimor-shkencor nga fusha e sintaksës.

## 1. Veprimtaria mësimore-arsimore:

Në vitin akademik 2006/2007, Berton Sulejmani zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore *asistent i ri* në fushën e Gjuhës shqipe.

Në vitin akademik 2012/2013 zgjidhet *docent* për lëndët mësimore *Sintaksa e gjuhës shqipe 1 dhe 2, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1 dhe 2 dhe Historia e gjuhës shqipe* në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

Më 23. 05. 2018 zgjidhet *profesor inordinar* për lëndët mësimore *Sintaksa e gjuhës shqipe 1 dhe 2, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1 dhe 2 dhe Historia e gjuhës shqipe* në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

Nga viti akademik 2018/2019 deri në vitin akademik 2022/2023 kandidati Prof. dr. Berton Sulejmani veprimtarinë mësimore-arsimore e realizoi duke mbajtur ligjërata dhe ushtrime në lëndët *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1 dhe 2, Sintaksa e gjuhës shqipe 1 dhe 2, Historia e gjuhës shqipe 1 dhe 2* programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe dhe në ciklin e dytë të studimeve lëndët *Studime për historinë e gjuhës shqipe, Gramatika e gjuhës shqipe II* programi studimor Gjuhë Shqipe dhe *Gramatika pedagogjike dhe Sintaksa e fjalisë së përbërë* programi studimor Metodika e Mësimdhënies së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Përveç ligjëratave dhe ushtrimeve, kandidati Prof. dr. Berton Sulejmani, realizon dhe konsultime me studentët e Fakultetin Filologjik, programi studimor: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe të lëndëve përkatëse në studimet deridiplomike dhe pasdiplomike.

Nga punësimi i tij në Universitetin e Tetovës (viti akademik 2006/07) deri më sot, dr. Berton Sulejmani vazhdimisht ka kryer dhe vazhdon të kryejë detyra të rëndësishme të katedrës, të fakultetit dhe të universitetit në të cilin është i punësuar, si: anëtar i Këshillit redaktues të revistës së Fakultetit Filologjik „Cogito“ (prej themelimit, dhjetor 2007, ISSN 1857 - 579X e deri kur u botua), anëtar i Këshillit redaktues dhe Këshillit organizativ i revistës shkencore „Filologjia“. Ndërsa nga viti 2009 vazhdon të jetë një nga koordinatorët e sesionit të gjuhësisë dhe anëtar i Këshillit drejtues të Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë të cilin e organizon Universiteti i Tetovës (këtë vit, pra në vitin 2022 u organizua i XVI-ti me radhë). Njashtu është edhe një nga koordinatorët e konferencës shkencore të Fakultetit të Filologjisë të cilën fakulteti e organizon për çdo vit.

Dr. Berton Sulejmani është autor i mbi 70 artikujve shkencorë (mbështetur në dokumentacionin e dërguar). Rezultat i shquar i veprimtarisë së tij kërkimore-shkencore është monografia me titull „Gjuha standarde shqipe dhe shkolla (zbatimi i saj nga nxënësit e shkollave të mesme të Shkupit)“ e botuar në vitin 2011. Deri më sot ka botuar edhe një doracak me titull „Doracak për mësimin e gjuhës joamtare (për mësimdhënësit në arsimin fillor, të mesëm e të lartë)“ (në bashkëautorësi, i cili është përkthyer në anglisht, maqedonisht dhe turqisht) në vitin 2016 librin me titull „Mbishkrimet e firmave private dhe institucioneve publike në qytetin e Shkupit“, (në bashkëautorësi me prof. dr. Mustafa Ibrahimini, në vitin 2016).

Dr. Berton Sulejmani në bashkëpunim me gjuhëtarë të shquar, në veçanti nga fusha e leksikografisë si: Haki Imeri, Petar Atanasovi dhe Veselinka Labroska ka botuar fjalorë dygjuhësh **Fjalor shqip-maqedonisht** dhe **Македонско-Албански речник** (të parët e këtij lloji) për nxënësit e shkollave fillore në Maqedoni. Këta fjalorë, përkatësisht projektin për hartimin e këtyre fjalorëve e ka mbështetur OSCE HCNM (Komisari i Lartë për Pakicat Kombëtare i OSCE-së & Dialog Nansen CENTER-SHKUP (ideja e kësaj të fundit) në vitin 2016. Në vitin 2018 botoi monografinë në gjuhën maqedonase me titull: „Конгруенција меѓу подметот и природот во албанскиот и во македонскиот јазик (споредбена анализа“, Arbëria Design, Tetovë, 2018. Në vitin 2019 librin: **Libër bashkëbisedimesh shqip-maqedonisht dhe maqedonisht-shqip**, B. Sulejmani dhe V. Labroska, OSCE HCNM (OSCE High Commissioner on National Minorities & NANSEN DIALOGUE CENTRE-SKOPJE, Shkup, 2019.

Ndërsa së fundi, pra në vitin 2022 (në bashkautorësi) hartuan librin i cili është vetëm në version elektronik dhe mund të shkarkohet falas, me titull: *Libër bashkëbisedimesh shqip-maqedonisht-turqisht-serbisht dhe maqedonisht-shqip-turqisht-serbisht*, B. Sulejmani dhe V. Labroska, OSCE HCNM (OSCE High Commissioner on National Minorities & NANSEN DIALOGUE CENTRE-SKOPJE, versioni elektronik: <https://fraza.mk> Shkup, 2022.

Distinktiv për arritjet e larta shkencore të dr. Berton Sulejmanit është edhe akreditimi i tij për mentorimin e studimeve master (studime të ciklit të dytë). Bordi i Akreditimit dhe i Vlerësimit i Arsimit të Lartë i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës e akreditoi dr. Berton Sulejmanin si mentor i studimeve master për Programin Studimor *Shkenca mbi gjuhën* (vendimi me nr. 17-338/3, i datës 28. XII. 2016) për programet studimore nga fusha e gjuhësisë, përkatësisht të gjuhës shqipe të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Tetovës.

Dr. Berton Sulejmani (në bashkëautorësi) ka përgatitur materiale nga fusha e fonetikës, e leksikologjisë dhe e gramatikës për emisionin televiziv *Të mësojmë shqip* nga viti 2014-2016 të Televizionit Kombëtar *Alsat-M*. Gjatë kësaj periudhe kohore, ky emision është transmetuar tri ditë brenda një javë (nga fillimi e deri në fund janë dhënë mbi 100 emisione nga fusha e kulturës së gjuhës).

Dr. Berton Sulejmani shquhet si lektor i dalluar i gjuhës shqipe dhe si përkthyes nga maqedonishtja në shqip dhe anasjelltas.

Në vitin 2016, nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, ka qenë i angazhuar për të hartuar 12 zëra nga fusha e albanologjisë, përkatësisht nga ajo e gjuhësisë shqiptare për Fjalorin Enciklopedik të Kosovës I (A – K) dhe II (L – Zh), Prishtinë, 2018.

Në kuadër të trajnimit të përkthyesve dhe të lektorëve të organizuar nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, Berton Sulejmani ka mbajtur ligjëratë me temë „Përkthimi letrar” (25 – 27 maj 2021).

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, kandidati **prof. dr. Berton Sulejmani** ka realizuar gjithsej **87.85 pikë** nga **veprimtaria mësimore-arsimore**.

## 2. Veprimtaria kërkimore-shkencore:

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati dr. Berton Sulejmani është marrë vazhdimisht me realizimin e veprimtarisë hulumtuese shkencore në fushën e shkencave filologjike, gjegjësisht në lëmin e gjuhësisë. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore. Krahas pjesëmarrjes së madhe në konferenca mbarëkombëtare e ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit, si dhe krahas punimeve kërkimore-shkencore të botuara në revista të ndryshme shkencore, komisioni ka veçuar vetëm ato që janë botuar dhe një pjesë që janë në proces të botimit, por që kandidati i ka prazantuar në konferenca e simpoziume shkencore nga viti 2018 e deri në vitin 2022. Kjo veprimtari e kandidatit është paraqitur si më poshtë:

### 2.1. Punime shkencore të lexuara/ të botuara në revista profesionale dhe ndërkombëtare

1. „Emri Shkup, Manastir e Tetovë në tekstet shkollore të viteve 1980-1989 dhe pas vitit 1991 në Maqedoni”, *Filologjia - International Journal of Human Sciences*, 9-10/2018, f. 27-31, ISSN: 1857-8535 (Print), ISSN: 2671-3012 (online), UDC: 811.18'373.21 (print form), Tetovë, 2018.

2. „Studimet gjuhësore të akademik Idriz Ajetit të botuara në Shkup”, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Konferencë jubilarë-shkencore e mbajtur në Prishtinë me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Akademik Idriz Ajetit, f. 241-252, Prishtinë, 2018.
3. „Kontributi i studiuesve të huaj në Universitetet e Perandorisë së Austro-Hungarisë për zhvillimin e gjuhës dhe shkollës shqipe”, *Albanologjia - International Journal of Albanology*, 9-10/2018, f. 13-21, ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919 (Online), UDC: 811.18:37, 81(497), 811.18(091) (print form), Tetovë, 2018.
4. „Kontributi i Profesor Remzi Nesimit për shqipen standarde në Maqedoni si dhe studimet e tij për sintaksën e gjuhës shqipe”, Sesioni shkencor: „Kontributi i prof. Remzi Nesimit për gjuhën shqipe dhe gjuhësinë shqiptare”, ITSHKSH, f. 97-108, Shkup, 2019.
5. „Konversioni dhe gjuha me frazeologji të pasur dukuri e veçantë e veprës letrare të Murat Isakut”, (në bashkautorësi), Konferencë shkencore „Zhvillimi i letërsisë shqipe në vitet 1945-1990”, e organizuar nga Universiteti „Aleksandër Moisiu” - Durrës në bashkëorganizim me Universitetin e Tetovës, Durrës, më 10 qershor 2019.
6. „Programi i sotëm studimor i katedrës së Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë të Universitetit të Tetovës për formimin e kuadrit parauniversitar”, Konferencë shkencore „Zhvillimet në shkencat e ligjërimit dhe lënda e gjuhës dhe e letërsisë në arsimin parauniversitar“, organizuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, në Tiranë, më 12.06.2019, f. 97-107, Tiranë, 2020.
7. „Shqipja standarde në mbishkrimet dhe në regjistrat e klasave të arsimit parauniversitar të qytetit të Shkupit”, Konferencë shkencore „10 vjet Java e Albanologjisë” e organizuar nga Instituti Albanologjik, Prishtinë, më 17-19 qershor 2019.
8. „Kongruenca e kryegjymtyrëve dhe funksioni sintaksori lidhëzës NDËRSA në gjuhën shqipe”, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, më 20 gusht 2019.
9. „Studimet gjuhësore të akademik Idriz Ajetit të botuara në revistën „Jehona” në Shkup”, revista Gjuha shqipe, viti XXXVI, 1/2019, f. 34-43, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019.
10. „Akademik Koleç Topalli, një personalitet i shquar i shkencave albanologjike”, *Albanologjia - International Journal of Albanology*, 11-12/2019, f. 54-58, ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919 (Online), UDC: 811.18:929 (print form), Tetovë, 2019.
11. „Gjuha shqipe në mbishkrimet private e publike në Maqedoninë e Veriut sot”, revista *Gjuha shqipe*, viti XXXVI, 2/2019, f. 57-64, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019.
12. „Kongruenca e kryegjymtyrëve të fjalisë dhe konversioni në romanet e Murat Isakut”, revista *Ars-Albanica*, nr. 8, ISSN: 2545-4781, f. 22-30, Tetovë, 2020.
13. „Tekstet për shkollat e mesme të Profesor Shaban Demirajt”, Fakulteti i Filologjisë dhe Historisë, Universiteti i Tiranës, 2020.
14. „Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë), Parafjalët e shqipes standarde“ (vepra të M. Çelikut)”, *Albanologjia - International Journal of Albanology*, 13-14/2020, f. 22-26, ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919 (Online), UDC: 811.18'367(049.3) (print form), Tetovë, 2020.
15. „Vështrimi ballkanik i botës i pasqyruar në leksikun e gjuhës shqipe dhe asaj maqedonase“, ITSHKSH, Konferencë shkencore „Figura e tjetrit në kulturën ballkanike”, *Ballkanologjia*, 2/2020, f. 224-232, Shkup, 2020. Ky punim nga botuesit është përkthyer edhe në maqedonisht: „Балканскиот поглед на светот одразен во лексиката на албанскиот и на македонскиот јазик” (во коавторство), ИДКНА, *Ballkanologjia* 2, Figura e tjetrit në kulturën ballkanike (akte të Konferencës shkencore ndërkombëtare, 26-27 tetor 2019), f. 233-241, Shkup, 2020.
16. „Gjuha standarde shqipe në arsimin parauniversitar të qytetit të Shkupit“, ITSHKSH, Konferencë shkencore „Gjuha dhe shkolla shqipe në Maqedoninë e Veriut”, *Scupi*, 31/2020, f. 78-94, Shkup, 2020.
17. „Emrat e vendeve në tabelat rrugore në RMV”, *Albanologjia - International Journal of Albanology*, 15-16/2021, f. 8-15, ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919 (Online), UDC: 81'373.21(497.7) (print form), Tetovë, 2021.

18. „Interkulturalizmi gjuhësor nëpërmjet frazeologjizmave në gjuhën shqipe dhe maqedonase”, Universiteti “Nënë Tereza”, Përmbledhje punimesh nga Konferenca III Shkencore Ndërkombëtare për Interkulturën me temë: “Arsimi interkulturore” mbajtur më datën 26.10.2020 në UNT- Shkup, Interkultura, 3/2020, f. 85-100, Shkup, 2020.
19. „Gjuha e urrejtjes në sport dhe në tubimet parazgjedhore politike – si dukuri etnolinguistike”, (në bashkautorësi), Universiteti i Tetovës, libri përmban analiza të bazuara nga të dhënat e mbledhura në kuadër të projektit “Gjuha e urrejtjes gjatë kampanjës zgjedhore parlamentare 2020 në RMV: efektet në sjelljen e qytetarëve në relacionet intergrupore. Ky projekt është financuar nga Universiteti i Tetovës, f. 39-53, Tetovë, 2021. Punimi i njëjtë, nga botuesit, është përkthyer edhe në maqedonisht dhe anglisht: „Говорот на омраза во спортот и предизборните политички средби – како етнолингвистички појави”, (во коавторство), Универзитет во Тетово, книгата содржи analizi засновани на податоци собрани во рамките на projektot: “Говорот на омраза за време на парламентарната изборна кампања во 2020 год. во Република Северна Македонија: ефекти врз однесувањето на граѓаните во меѓу групните односи“. Овој проект е финансиран од Универзитетот во Тетово, стр. 177-191, Тетово, 2021. „Hate speech in sport and in pre-election political rallies-as ethno-linguistic phenomena”, (in co-authorship), University of Tetova, the book contains analyzes based on data collected within the project: "Hate speech during the parliamentary election campaign in 2020 in the Republic of North Macedonia: effects on the behavior of citizens in intergroup relations". This project is financed by the University of Tetovo, pg. 177-191, Tetova, 2021.
20. „Kumtesat shkencore të akademik Jani Thomait të botuara në revistën e Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë të Universitetit të Tetovës”, Instituti Albanologjik, *Albanologji*, 11/2020, f. 91-102, Prishtinë, 2021.
21. „Toponimia shqiptare në tabelat rrugore në Maqedoninë e Veriut”, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, punimet e konferencës, Konferenca shkencore ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, mbajtur më 20-22 shkurt 2020 në Shkup, f. 60-64, Shkup, 2021. Punimi i njëjtë, nga botuesit, është përkthyer edhe në maqedonisht dhe anglisht: „Албанската топонимија на патните табли во Северна Македонија“, Агенција за примена на јазикот на РСМ, зборник трудови, Меѓународна научна конференција за меѓународниот ден на мајчиниот јазик одржана на 20-22 февруари 2020 година во Скопје, стр. 60-64, Скопје, 2021. „Albanian toponyms in road signposts in North Macedonia“, Language Implementation Agency of RNM, book of proceedings, International scientific conference for the international day of mother tongue, held on 20-22 February 2020, Skopje, pg. 60-64, Skopje, 2021.
22. „Studimet albanologjike të akademik Idriz Ajetit të botuara në Shkup”, *Studime Albanologjike*, 21/2021, f. 55-63, ISSN: 1857-6958 (print form), Shkup, 2021.
23. „Në ç'trajtë duhet t'i shkruajmë toponimet në pullat postare”, Instituti Albanologjik, revista *Gjuha shqipe*, viti XXXIX, 1/2021, f. 21-22, Prishtinë, 2021.
24. „Gjuha shqipe në Maqedoninë e Veriut (gjatë pandemisë me Kovid-19 dhe Kampionatit Evropian të Futbollit)”, Instituti Albanologjik, revista *Gjuha shqipe*, viti XXXIX, 3/2021, f. 55-58, Prishtinë, 2021.
25. „Disa veçori sintaksore në prozën e Mitrush Kutelit”, *Albanologjia - International Journal of Albanology*, 17-18/2022, f. 10-15, ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919 (Online), UDC: 821.18-3:811.18'367 (print form), Tetovë, 2022.
26. „Profesor Xhevat Gega bashkautor i gramatikave të shkollave fillore”, ITSHKSH, Konferencë shkencore „Figura poliedrike e Profesor Xhevat Gegës”, *Scupi*, 34/2022, f. 98-106, Shkup, 2022.
27. „Gjuha shqipe në përdorim zyrtar e jo gjuhë zyrtare në Maqedoninë e Veriut sot”, Konferencë Shkencore Ndërkombëtare „Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan: arritje dhe perspektiva“, f. 67-82, Korçë, 2022.
28. „Kur filluan të botohen artikujt për mësonjëtoaren e parë shqipe në gazetën „Flaka e vëllazërimit””, *Filologjia - International Journal of Human Sciences*, 17-18/2022, f. 8-15, ISSN: 1857-8535 (Print), ISSN: 2671-3012 (online), UDC: 811.18(091) & 070(497.7:=18)(091) (print form), Tetovë, 2022.

29. „Disa këshilla përkthyesve të veprave letrare nga maqedonishtja në gjuhën shqipe”, Universiteti i Gjakovës, konferencë shkencore ku Fakulteti Filologjik i Universitetit të Tetovës ishte bashkorganizator, Gjakovë, 2022 (Në proces të botimit. Një pjesë e kumtesës, nga ana e organizatorëve të konferencës, është botuar në gazetën e përjavshme letrare & kulturore ExLibris). Ja edhe vegëzën elektronike: <https://exlibris.al/ber-ton-sulejmani-disa-keshilla-perkthyesve-te-veprave-letrare-nga-maqedonishtja-ne-gjuhen-shqipe/>
30. „Trajtesa sintaksore në revistën Gjuha shqipe”, Instituti Albanologjik, konferencë shkencore që është mbajtur në qershor, Prishtinë, 2022.
31. „Ndikimet ndërgjuhësore ndërmjet shqipes e maqedonishtes”, (në bashkautorësi), Universiteti i Prishtinës, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, gusht, 2022.
32. „Toponimia shqipe në komunën e Butelit“, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, Konferenca shkencore që është mbajtur në shtator, Shkup, 2022.
33. „Gjuha shqipe në Maqedoninë e Veriut sot (shqipja standarde dhe statusi i pabarabartë i shqipes me maqedonishten)”, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, konferencë shkencore që u organizua më 17 nëntor, Prishtinë, 2022.
34. „Ndikimet ndërgjuhësore të shqipes e të maqedonishtes në fushën e leksikut”, Universiteti i Beogradit, konferencë shkencore që është mbajtur në nëntor, Beograd, 2022.
35. „Albanologjia në Shkup dhe Universiteti i Tetovës” (ndihmesa e profesorëve të Katedrës së Albanologjisë për ngritjen dhe fuqizimin e Fakultetit Filologjik të UT-së), Konferencë Shkencore Ndërkombëtare „50 vjet gjuhë, letërsi e kulturë shqiptare në Fakultetin e Filologjisë në Shkup; 50 vjet shkruajmë e flasim njësoj” Shkup, më 21 nëntor 2022.

## 2.2. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare:

1. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Seminarin e XII Ndërkombëtar të Albanologjisë me temë: „Skënderbeu mes historisë dhe letërsisë“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **28 shtator 2018**.
2. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Pestë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik me temë: „Prurje të reja për gjuhën, letërsinë dhe kulturën“, Universiteti i Tetovës, **7 dhjetor 2018**.
3. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Seminarin e XIII Ndërkombëtar të Albanologjisë me temë: „Gjuha, letërsia dhe identiteti“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **25-26 shtator 2019**.
4. **Mirënjohje** për pjesëmarrje në Konferencën Shkencore me temë: „Gjuha dhe shkolla shqipe në Maqedoninë e Veriut“, organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, **24 shtator 2020**.
5. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Tretë Shkencore Ndërkombëtare për Interkulturalizmin organizuar nga Universiteti „Nënë Tereza“ – Shkup, **26 tetor 2020**.
6. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Tribunën Shkencore me temë: „Figura poliedrike e profesor Xhevat Gegës“, organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, **1 shtator 2021**.
7. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: „Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan: arritje dhe perspektiva“, organizuar nga Universiteti i Korçës „Fan S. Noli“, **12 nëntor 2021**.
8. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Seminarin e XV Ndërkombëtar të Albanologjisë me temë: „Shqiptarët dhe kultura e kujtesës“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **22 nëntor 2021**.
9. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: „Çështje të gjuhës, letërsisë dhe përkthimit letrar“, organizuar nga Universiteti i Gjakovës „Fehmi Agani“, **17 qershor 2022**.
10. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Seminarin e XVI Ndërkombëtar të Albanologjisë me temë: „Kultura dhe globalizimi“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **28-29 shtator 2022**.

11. **Certifikatë** për pjesëmarrjen Konferencën kushtuar 101 vjetorit të Katedrës së Albanologjisë në Universitetin e Beogradit, organizuar nga Fakulteti Filologjik i Universitetit të Beogradit, **27-28 tetor 2022**.

12. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Shtatë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik me temë: „Gjuha, letërsia dhe kultura – arritjet dhe perspektivat“, Universiteti i Tetovës, **16-18 nëntor 2022**.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, kandidati **prof. dr. Berton Sulejmani** ka realizuar gjithsej **151 pikë** nga **veprimtaria kërkimore-shkencore**.

### **3. Veprimtaria profesionale-aplikative:**

#### **3.1. Libra nga fusha profesionale**

1. „**Gjuha standarde shqipe dhe shkolla (zbatimi i saj nga nxënësit e shkollave të mesme të Shkupit)**“, Logos-A, Shkup, 2011. ISBN - 978-9989-58-401-5

2. „**Doracak për mësimin e gjuhës joamtare (për mësimdhënësit në arsimin fillor, të mesëm e të lartë)**“, botues: Këshilli Britanik në Maqedoni, (COBISS.MK-ID 86773002) (në bashkautorësi), Shkup, 2011. ISBN - 978-9989-2723-4-9

3. „**Gjuha e firmave dhe mbishkrimet publike në qytetin e Shkupit**“, (në bashkautorësi) Interlingua, Shkup, 2016.

4. **Fjalor shqip-maqedonisht**, V. Labroska & B. Sulejmani & H. Imeri-Bina & P. Atanasov, OSCE HCNM (OSCE High Commissioner on National Minorities & NANSEN DIALOGUE CENTRE-SKOPJE, Shkup, 2016.

5. **Македонско-Албански речник**, В. Лаброска & Б. Сулејмани & Х. Имери-Бина & П. Атанасов, OSCE HCNM (OSCE High Commissioner on National Minorities & NANSEN DIALOGUE CENTRE-SKOPJE, Скопје, 2016.

6. „**Конгруенција меѓу подметот и прирокот во албанскиот и во македонскиот јазик (споредбена анализа)**“, ArbëriaDesign, Tetovë, 2018. ISBN - 978-608-236-238-0.

7. **Libër bashkëbisedimesh shqip-maqedonisht dhe maqedonisht-shqip**, B. Sulejmani dhe V. Labroska, OSCE HCNM (OSCE High Commissioner on National Minorities & NANSEN DIALOGUE CENTRE-SKOPJE, Shkup, 2019. ISBN - 978-608-245-490-0.

8. **Libër bashkëbisedimesh shqip-maqedonisht-turqisht-serbisht dhe maqedonisht-shqip-turqisht-serbisht**, B. Sulejmani dhe V. Labroska, OSCE HCNM (OSCE High Commissioner on National Minorities & NANSEN DIALOGUE CENTRE-SKOPJE, version elektronik: <https://faza.mk> Shkup, 2022.

#### **3.2. Koordinator për përgatitjen e elaboratit për programi studimor të ri**

1. Koordinator për përgatitjen e elaboratit të programit studimor të ciklit të parë Gjuhë dhe Letërsi Shqipe 2021.

2. Koordinator për përgatitjen e elaboratit të programit studimor të ciklit të dytë të programit studimor Gjuhë Shqipe 2021.

3. Koordinator për përgatitjen e elaboratit të programit studimor të ciklit të dytë të programit studimor Metodika e mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe 2021.



### 3.3. Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit

Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezantim i programit studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe 2018, 2019, 2020, 2021, 2022.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, kandidati **prof. dr. Berton Sulejmani** ka realizuar gjithsej **32.5 pikë** nga **veprimtaria profesionale-aplikative**.

## 4. Veprimtari me interes më të gjerë:

### 4.1. Anëtar i këshillit redaktues të revistës shkencore / profesionale ndërkombëtare

1. Filologjia - *International Journal of Human Sciences*, University of Tetova, ISSN: 1857-8535 (Print), ISSN: 2671-3012 (online).
2. Albanologjia - *International Journal of Albanology*, University of Tetova, ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919 (online).
3. Revista shkencore *Gjuha shqipe*, Instituti Albanologjik i Prishtinës.
4. Recensent i *Monografisë me rastin e 101-vjetorit të mësimdhënies së gjuhës shqipe në Universitetin e Beogradit*, Beograd, 2022.

### 4.2. Anëtar i këshillit organizues ose programor i tubimit ndërkombëtar shkencor/profesional

1. Seminari XII Ndërkombëtar i Albanologjisë me temë: „Skënderbeu mes historisë dhe letërsisë“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **28 shtator 2018**.
2. Konferenca e Pestë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Filologjik me temë: „Prurje të reja për gjuhën, letërsinë dhe kulturën“, Universiteti i Tetovës, **7 dhjetor 2018**.
3. Seminari XIII Ndërkombëtar i Albanologjisë me temë: „Gjuha, letërsia dhe identiteti“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **25-26 shtator 2019**.
4. Konferenca e Gjashtë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Filologjik me temë: „Gjuha, letërsia dhe kultura në shekullin XXI“, Universiteti i Tetovës, **13-15 nëntor 2019**.
5. Seminari XIV Ndërkombëtar i Albanologjisë me temë: „Sfidat e (mos)zbatimit të ligjit të gjuhëve në Maqedoninë e Veriut dhe gabimet gjatë përdorimit të shqipes standarde“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **25 nëntor 2020**.
6. Seminari XV Ndërkombëtar i Albanologjisë me temë: „Shqiptarët dhe kultura e kujtesës“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **22 nëntor 2021**.
7. Seminari XVI Ndërkombëtar i Albanologjisë me temë: „Kultura dhe globalizimi“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **28-29 shtator 2022**.
8. Konferenca e Shtatë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Filologjik me temë: „Gjuha, letërsia dhe kultura – arritjet dhe perspektivat“, Universiteti i Tetovës, **16-18 nëntor 2022**.

### 4.3. Anëtar i komisioneve në fakulet/universitet

1. Anëtar i komisionit për transfer në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.
2. Kryetar i komisionit për regjistrim të studentëve në ciklin e parë në Fakultetin Filologjik, viti akademik 2020/2021.

3. Kryetar i komisionit për regjistrim të studentëve në ciklin e dytë në Fakultetin Filologjik, viti akademik 2020/2021.
4. Kryetar i komisionit për regjistrim të studentëve në ciklin e parë në Fakultetin Filologjik, viti akademik 2021/2022.
5. Kryetar i komisionit për regjistrim të studentëve në ciklin e dytë në Fakultetin Filologjik, viti akademik 2021/2022.
6. Kryetar/anëtar i Komisionit për zgjedhje/rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore.
7. Anëtar i Komisionit për veprimtari botuese të Universitetit të Tetovës (vendimi me nr. 12-4686/1 i datës 12. XII. 2019).

#### 4.4. Anëtar në institucione relevante arsimore e shkencore të RMV

1. Kryetar i Komisionit për botimeve të vitit 2019 në Ministrinë e Kulturës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, (vendimi me nr. 52-12944/1 i datës 19. XI. 2018).
2. Kryetar i Komisionit për botimeve të vitit 2020 në Ministrinë e Kulturës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, (vendimi me nr. 53-12494/1 i datës 12. XI. 2019).

#### 4.5. Udhëheqës i programit studimor

1. Shef i programit studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Fakulteti Filologjik, 22. II. 2015 - 27. II. 2019.

#### 4.6. Dekan

1. Ushtrues detyre Dekan i Fakultetit Filologjik, 28. II. 2019 - 30. IX. 2019 (vendimi me nr. 02-818/1 i datës 28. II. 2019).
2. Dekan i Fakultetit Filologjik, 01. X. 2019 - 30. IX. 2022 (vendimi me nr. 02-4311/1 i datës 14. X. 2019).
3. Dekan i Fakultetit Filologjik, 01. X. 2022 - 30. IX. 2025 (vendimi me nr. 18-3585/1 i datës 21. X. 2022).

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, kandidati **prof. dr. Berton Sulejmani** ka realizuar gjithsej **44.5 pikë** nga **veprimtaria me interes më të gjerë**.

## 5. Formulari për raportin për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore

Në shtojcat e mëposhtme është bashkëngjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati prof. dr. Berton Sulejmani ka siguruar gjithsej **315.85** pikë, përkatësisht në: veprimtarinë mësimore-arsimore **87.85** pikë, veprimtarinë kërkimore-shkencore **151** pikë, veprimtarinë profesionale-aplikative **32.5** pikë dhe në veprimtarinë me interes më të gjerë **44.5** pikë.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN		Pikët
I.	VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	87.85
II.	VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE	151
III.	VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	32.5
IV.	VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË	44.5
<b>Gjithsej</b>		<b>315.85</b>

## 6. Përfundim dhe propozim:

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes të përgjithshëm dhe konstaton se kandidati **Prof. dr. Berton Sulejmani** në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, ka grumbulluar **315.85 pikë** nga referencat profesionale, me këtë e ka tejkaluar numrin minimal të pikëve që janë të nevojshme për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **profesor ordinar**.

Në bazë të aktivitetit të përgjithshëm të kandidatit nga zgjedhja e fundit e deri më tani, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë që Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, t'i propozojë që kandidatin **Prof. dr. Berton Sulejmani** ta zgjedhë në thirrjen mësimore-shkencore **profesor ordinar** në lëmin Fonetikë, Fonologji (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1 dhe 2), Gramatika, Semantika, Semiotika, Sintaksa (Sintaksa e gjuhës shqipe 1 dhe 2) dhe Historia e gjuhës (Historia e gjuhës shqipe 1 dhe 2), (64013, 64014, 64018, 64020 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Tetovë, 05. XII. 2022

### Komisioni recensues:

**1. Prof. dr. Asllan HAMITI** (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin Filologjik „Bllazhe Koneski“ të Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ – Shkup

---

**2. Prof. dr. Izmit DURMISHI** (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës

---

**3. Prof. dr. Valbona TOSKA** (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Filologjik „Bllazhe Koneski“ të Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ – Shkup

---

## FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË,  
MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Berton Vebi Sulejmani**

Institucioni: **Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Fonetikë, Fonologji (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1 dhe 2), Gramatika, Semantika, Semiotika, Sintaksa (Sintaksa e gjuhës shqipe 1 dhe 2) dhe Historia e gjuhës (Historia e gjuhës shqipe 1 dhe 2), (64013, 64014, 64018, 64020 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

### KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN MËSIMOR-SHKENCOR – PROFESOR ORDINAR

Nr.	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Titulli shkencor – doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet Emri i sferës shkencore: <b>Shkencat humane (6), fusha Shkenca mbi gjuhësinë (604), sfera Fonetikë, Fonologji (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1 dhe 2), Gramatika, Semantika, Semiotika, Sintaksa (Sintaksa e gjuhës shqipe 1 dhe 2) dhe Historia e gjuhës (Historia e gjuhës shqipe 1 dhe 2), (64013, 64014, 64018, 64020)</b>	Po
2	Të publikuara së paku 6 (gjashtë) punime shkencore të recensuara <sup>1</sup> në publikime shkencor referente në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	Po
2.1	Revistë shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensioneve dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime shkencore të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emeral, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër të revistave, të cilën do ta përcaktojë Këshilli kombëtar i arsimit të lartë  1. Emri i revistës shkencore: <b>Filologjia - International Journal of Human Sciences</b> 2. Emri i bazës elektronike të revistës: <b>Ebsco</b> 3. Titulli i punimit: <b>„Kur filluan të botohen artikujt për mësonjëtoeren e parë shqipe në gazetën „Flaka e vëllazërimit”</b> 4. Data e publikimit: <b>ISSN: 1857-8535 (Print), ISSN: 2671-3012, 2022</b>	Po

<sup>1</sup> Për kandidatin/ët që ka publikuar më tepër se 6 (gjashtë) punime shkencore në publikime shkencore referente, komisioni recensues do t'i theksojë, vlerësojë me pikë dhe vendos në Formularin 2.

	<p>1. Emri i revistës shkencore: <b>Albanologjia - International Journal of Albanology</b></p> <p>2. Emri i bazës elektronike të revistës: <b>Ebsco</b></p> <p>3. Titulli i punimit: <b>„Disa veçori sintaksore në prozën e Mitrush Kutelit“</b></p> <p>4. Data e publikimit: <b>ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919, 2022</b></p>	
2.2	<p>Një revistë shkencore në të cilën punimet e botuara janë të recensuara dhe e cila ka bord redaktues ndërkombëtar në të cilin marrin pjesë anëtarë nga të paktën tre vende, dhe nuri i anëtarëve nga një vend nuk mund të kalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <b>Albanologjia - International Journal of Albanology</b></p> <p>2. Këshilli redaktues ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendeve): <b>36 - numri i përgjithshëm, 11 vende: Albania, Bosnia and Herzegovina, Bullgaria, Croatia, Hungaria, Kosovo, Georgia, Germany, Romania, Switzerland, Turkey</b></p> <p>3. Titulli i punimit: <b>„Emrat e vendeve në tabelat rrugore në RMV“</b></p> <p>4. Data e publikimit: <b>ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919 (Online), 2021</b></p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <b>Filologjia - International Journal of Human Sciences</b></p> <p>2. Këshilli redaktues ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendeve): <b>45 - numri i përgjithshëm, 10 vende: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Hungaria, Kosova, Gjeorgjia, Gjermania, Rumania, Turqia.</b></p> <p>3. Titulli i punimit: <b>„Emri Shkup, Manastir e Tetovë në tekstet shkollore të viteve 1980 - 1989 dhe pas vitit 1991 në Maqedoni“</b></p> <p>4. Data e publikimit: <b>ISSN: 1857-8535 (Print), ISSN: 2671-3012 (Online), 2018</b></p>	Po
3	<p>Libër mësimor i recensuar dhe publikuar, monografi, praktikum ose përmbledhje detyrash nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet**</p> <p>1. Titulli i librit mësimor, monografisë, praktikumit ose përmbledhjes së detyrave: <b>„Libër bashkëbisedimesh shqip-maqedonisht-turqisht-serbisht dhe maqedonisht-shqip-turqisht-serbisht“</b></p> <p>2. Vendi dhe data e botimit: <b>Shkup, 2022</b></p> <p>1. Titulli i librit mësimor, monografisë, praktikumit ose përmbledhjes së detyrave: <b>„Libër bashkëbisedimesh maqedonisht-shqip, shqip-maqedonisht“</b></p> <p>2. Vendi dhe data e botimit: <b>Shkup, 2019</b></p>	Po

\*\* Kushti i theksuar do të zbatohet pas kalimit të tri viteve nga hyrja në fuqi e Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 82/2018).

	<p>1. Titulli i librit mësimor, monografisë, praktikumit ose përmbledhjes së detyrave: <b>„Конгруенција меѓу подметот и природот во албанскиот и во македонскиот јазик“</b></p> <p>2. Vendi dhe data e botimit: <b>Tetovë, 2018</b></p>	
4	<p>Zgjedhja e mëparshme në titullin mësimor-shkencor – profesor inordinar, data dhe numri i buletinit: <b>23. V. 2018, buletini 129</b></p>	<b>Po</b>
5	<p><b>Posedon aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë</b></p> <p>1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë <b>Universiteti i Tetovës</b></p> <p>2. Lloji i trajnimit/përvoja/arsimimi për fitimin e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë <b>Mësimdhënie</b></p> <p>3. Periudha e fitimit të shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë <b>2006-2022</b></p>	<b>Po</b>

## FORMULARI 2

PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË DHE  
MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Berton Vebi Sulejmani**

Institucioni: **Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Fonetikë, Fonologji (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1 dhe 2), Gramatika, Semantika, Semiotika, Sintaksa (Sintaksa e gjuhës shqipe 1 dhe 2) dhe Historia e gjuhës (Historia e gjuhës shqipe 1 dhe 2), (64013, 64014, 64018, 64020 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

### I. VEPRIMTARIA MËSIMORË-ARSIMORË

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	Pikët
<b>1</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave</b> (cikli i parë i studimeve)					<b>24</b>
1.1	<b>Sintaksa e gjuhës shqipe 1</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	3	15	5	9
1.2	<b>Sintaksa e gjuhës shqipe 2</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	3	15	5	9
1.3	<b>Historia e gjuhës shqipe</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	2	15	5	6
<b>2</b>	<b>Mbajtja e ushtrimeve</b> (cikli i parë i studimeve)					<b>24.75</b>
2.1	<b>Sintaksa e gjuhës shqipe 1</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	2	15	5	4.5
2.2	<b>Sintaksa e gjuhës shqipe 2</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	2	15	5	4.5
2.3	<b>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	3	15	5	6.75
2.4	<b>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 2</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	3	15	5	6.75
2.5	<b>Historia e gjuhës shqipe</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	1	15	5	2.25
<b>3</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave</b> (cikli i dytë i studimeve)					<b>8</b>
3.1	<b>Studime për historinë e gjuhës shqipe</b> (Gjuhë Shqipe)	0.05	2	10	2	2
3.2	<b>Gramatika e gjuhës shqipe II</b> (Gjuhë Shqipe)	0.05	2	10	2	2
3.3	<b>Gramatika pedagogjike</b> (Metodika e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe)	0.05	2	10	2	2
3.4	<b>Sintaksa e fjalisë së përbërë</b> (Metodika e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe)	0.05	2	10	2	2

<b>4</b>	<b>Mbajtja e ushtrimeve</b> (cikli i dytë i studimeve)	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	<b>2.4</b>
<b>4.1</b>	<b>Studime për historinë e gjuhës shqipe</b> (Gjuhë Shqipe)	0.03	1	10	2	<b>0.6</b>
<b>4.2</b>	<b>Gramatika e gjuhës shqipe II</b> (Gjuhë Shqipe)	0.03	1	10	2	<b>0.6</b>
<b>4.3</b>	<b>Gramatika pedagogjike</b> (Metodika e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe)	0.03	1	10	2	<b>0.6</b>
<b>4.4</b>	<b>Sintaksa e fjalisë së përbërë</b> (Metodika e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe)	0.03	1	10	2	<b>0.6</b>
<b>5</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave</b> (cikli i tretë i studimeve)	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	<b>3.6</b>
<b>5.1</b>	<b>Shkrim akademik</b> (Lëndë e përbashkët në nivel të gjithave drejtimeve)	0.06	3	4	5	<b>3.6</b>
<b>6</b>	<b>Konsultime me studentët</b>					<b>0.8</b>
<b>6.1</b>	Konsultimet me studentë	40x10x0.002				<b>0.8</b>
<b>7</b>	<b>Mentorim</b>					<b>14</b>
<b>7.1</b>	Mentor i temave të diplomës	25 x 0.2				<b>5</b>
<b>7.2</b>	Mentor i temave të magjistraturës	9 x 1				<b>9</b>
<b>8</b>	<b>Anëtar i komisioneve</b>					<b>10.3</b>
<b>8.1</b>	Anëtar komisioni për mbrojtjen e punimeve të diplomës, cikli I	37 x 0.1				3.7
<b>8.2</b>	Anëtar komisioni për mbrojtjen e punimeve të magjistraturës, cikli II	17 x 0.3				5.1
<b>8.3</b>	Anëtar komisioni për mbrojtjen e punimeve të doktoraturës, cikli III	3 x 0.5				1.5
<b>Gjithsej (1+2+3+4+5+6+7+8)</b>						<b>87.85</b>

## II. VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>1</b>	<b>Teza të mbrojtura</b>	<b>12</b>
<b>1.1</b>	<b>Berton Sulejmani:</b> „Kongruenca e gjymtyrëve kryesore të fjalisë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase - analizë krahasimtare“, Fakulteti Filologjik „Bllazhe Koneski“ i Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ –Shkup, tezë e doktoraturës	<b>8</b>
<b>1.2</b>	<b>Berton Sulejmani:</b> „Niveli i zotërimit të shqipes standarde nga nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Shkupit“, Fakulteti Filologjik „Bllazhe Koneski“ i Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ –Shkup, tezë e magjistraturës	<b>4</b>
<b>2</b>	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë shkencore/profesionale</b>	<b>104</b>
<b>2.1</b>	<b>Berton Sulejmani:</b> „Emri Shkup, Manastir e Tetovë në tekstet shkollore të viteve 1980-1989 dhe pas vitit 1991 në Maqedoni“, <i>Filologjia - International Journal of Human Sciences</i> , 9-10/2018, f. 27-31, ISSN: 1857-8535 (Print), ISSN: 2671-3012 (online), UDC: 811.18'373.21 (print form), Tetovë, 2018	<b>5</b>
<b>2.2</b>	<b>Berton Sulejmani:</b> „Studimet gjuhësore të akademik Idriz Ajetit të botuara në Shkup“, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Konferencë jubilarë-	<b>4</b>



	shkencore e mbajtur në Prishtinë me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Akademik Idriz Ajetit, f. 241-252, Prishtinë, 2018	
